

[Të Reja](#) ▾[Policia e Shtetit](#) ▾[Shërbime](#) ▾[Baza ligjore](#)[Vendndodhjet e policisë](#)[Video](#)[Programi i transparencës](#) ▾[Kontakt](#)

Denonco Krimin Kibernetik

Lajmet e Fundit:

DVP Durrës – Finalizohet operacioni policor i koduar “Skema”, për goditjen e skemave mashtruese që sjellin dëme të mëdha ekonomike



Lajmet

04/11/2021

Vlorë/Qarkullonte me armë zjarri me vete dhe tentoi të largohet, kapet dhe vihet në pranga 20-vjeçari

Në pranga dhe 2 shtetas të tjerë që tentuan të largoheshin me të, njëri prej tyre me masë sigurie “Arrest në shtëpi” për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotike”.

Sekuestrohet një armë zjarri pistoletë dhe municion luftarak.

Shërbimet e Forcës së Posaçme “Shqiponja”, në vijim të punës për evidentimin dhe goditjen e paligjshmërisë në fushën e armëmbajtjes pa leje, me qëllim rritjen e parametrave të sigurisë, bazuar dhe në informacionet e marra në rrugë operative, kanë ndaluar për kontroll disa shtetas, në lagjen “Partizani”, Vlorë.

Tre prej tyre, shtetasit M. B., Xh. L. dhe Ç. V., kanë tentuar t’i shmangen kontrollit fizik, duke u larguar me vrap. Njëri prej tyre, shtetasi M. B., ka hedhur nga çanta e tij e dorës, një armë zjarri pistoletë. Brenda pak minutash, të tre këta shtetas janë kapur dhe vënë në pranga nga punonjësit e Forcës së Posaçme “Shqiponja”.

Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan arma e zjarrit tip pistoletë dhe 1 krehër me fishekë luftarak.

Në përfundim të veprimeve, nga specialistët për Hetimin e Krimin në Komisarariat të Policisë Vlorë u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve:

- M. B., 20 vjeç, për veprën penale “Armëmbajtja pa leje”;
- Xh. L., 29 vjeç, për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”;
- Ç. V., 25 vjeç, për veprat penale “Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit” dhe “Moskallëzimi i krimit”.

Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për veprime të mëtejshme.

Share

Share

Share

Share

Email

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Shërbimi Për Qështjet e Brendshme dhe Ankesat](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Gjirokastër – Vihet në pranga 1 shtetas

Sarandë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Butrinti” ▶